



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4634 Prot

Lezhë, më 26 / 4 /2023

VENDIM

Nr. 32, Datë 25. 04.2023

PËR  
“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJARËVE TË FËMIJËVE TË PROJEKTIT  
“SHËRBIMI LËVIZËS PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, PËR  
MBËSHTETJE FINANCIARE”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në shkresën me nr prot. 3319, Lezhë me datë 23.03.2023, kërkesë për miratim fondi për shfrytëzimin e fondit të parashikuar për ‘Mbështetje ekonomike për familjarët e projektit’ me vlerë **500 000 lekë**, në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 11, datë 21.02.2023, në kuadër të fondit social me vlerë totale 1 172 000 lekë për vitin 2023 i cili bashkëfinancohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Projekti “Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social e Bashkisë Lezhë kërkon të shfrytëzojë fondin e parashikuar për “Mbështetje ekonomike për familjet e projektit”, me vlerë 500 000 lekë. Mbështetja financiare do t’ju ofrohet 35 familjeve që marrin shërbim pranë projektit që prej vitit 2020. Familjet janë përzgjedhur nga specialistët e ekipit në fillim të projektit, duke i evidentuar si familjet më në nevojë, të cilat jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike. 35 familjet janë të shpërndarë në të gjithë Njesitë Administrative. Nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së familjeve të fëmijëve që janë të përfshirë në projektin “Shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”, të cilët do të mbështeten financiarisht.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



Prot 4634/  
DT 27.4.23.

KB.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 357/8 Prot.

Lezhë, më 27.04.2023

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr.32, datë 25.04.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e listës së familjarëve të fëmijëve të projektit "Sherbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara" për mbështetje financiare"

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

